



BiEPAG



Të gjendur mes dy zjarreve: Opinionimi publik dhe integrimi evropian në Ballkanin Perëndimor

Qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë ende përgjithësisht pozitivë për perspektivat për t'u bërë qytetarë të Bashkimit Evropian. Megjithatë, rruga drejt shtetësisë evropiane është e gjatë dhe për momentin popujt gjenden mes dy zjarreve. Procesi i anëtarësimit në BE duket i pafund dhe shtetet aktuale anëtare po bëjnë shumë pak për të përmirësuar këtë proces (ku në fakt disa duket se po vendosin pengesa të tjera në këtë rrugëtim). Nga ana tjetër, qeveritë, politikanët dhe institucionet e këtyre vendeve janë fokusi i pakënaqësisë së njerëzve. Publiku është skeptik për angazhimin e qeverisë së tyre në integrimin evropian dhe kjo minon vlerën vlerën e demokracisë.

Depolitizimi i procesit të anëtarësimit po sjell pasoja të paparashikuara duke ua bërë të pamundur votuesve t'u kërkojnë llogari siç duhet për këtë çështje përfaqësuesve të tyre të zgjedhur. Për të shpëtuar nga këto dy zjarre, Komisioni Evropian duhet të përshpejtojë zbatimin e metodologjisë së rishikuar të zgjerimit, ku të rrisë më shumë stimujt për vazhdimin e reformës. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ftohen për të dhënë kontributin e tyre në procesin e përcaktimit të vizionit për të Ardhmen e Evropës. Bashkimi Evropian duhet të përforcojë mbështetjen aktuale për qytetarët dhe shoqërinë civile që t'i kërkojnë llogari qeverisë dhe t'i japin fund epidemisë së kapjes së shtetit në këtë rajon.

Corina Stratulat, Marko Kmezić, Nikolaos Tzifakis, Matteo Bonomi, Zoran Nechev¹

Një premtim kryesor i demokracisë është të fuqizojë njerëzit që këta të fundit t'i marrin vetë vendimet e tyre dhe të bëjnë që të dëgjohet zëri i tyre në politikë. Një problem gjithnjë e në rritje i demokracive moderne është se votuesit nuk besojnë më se mund të ndikojnë në mënyrën se si qeveriset vendi i tyre, edhe kur janë dakord se zgjedhjet janë të lira dhe të ndershme. Mandatet që u jepen udhëheqësve politikë nga qytetarët e zakonshëm gjatë fushatave zgjedhore shpesh përfundojnë në plan të fundit për shkak të një sërë mandatesh të tjera ligjërish të detyrueshme që qeveritë kanë ndërmarrë vazhdimisht nga Komisioni Evropian, Banka Qendrore Evropiane, gjykata të ndryshme dhe institucionet financiare ndërkombëtare. Shkombëtarizimi gradual i shumë aspekteve të politikëbërjes, veçanërisht në Evropën e periudhës së pas Traktatit të Maastrichtit, i ka lënë zgjedhësit të ndjehen si të lënë jetimë nga përfaqësuesit e tyre politikë dhe të zhgënjyer thellësisht me politikën konvencionale.²

Situata nuk përmirësohet as për qytetarët e vendeve të Ballkanit Perëndimor që kërkojnë të anëtarësohen në BE. Kur vjen puna për procesin e integritimit evropian të Ballkanit Perëndimor, popujt e shteteve të rajonit që duan të integrohen në BE gjenden faktikisht mes dy zjarreve. Një zjarr lidhet me natyrën teknokratike të procesit të integritimit evropian dhe pavendosmërinë e kryeqyteteve të BE-së për dosjen e zgjerimit. Zjarri tjetër ka të bëjë me paaftësinë –dhe shpesh me mungesën e vullnetit– të qeverive të Ballkanit për të vepruar me përgjegjshmëri dhe dinjitet gjatë kohës së ushtrimit të mandatit.

Është një gjë të presësh që qytetarët e rajonit të pranojnë modelin e Komisionit për ndryshim përmes 'reformave pa politikë' nëse sjellin si rezultat qeverisjen e mirë dhe anëtarësimin në BE. Gjithsesi, është mjaft e vështirë të supozohet se konsensusi aktual popullor e disi tolerant në rajon në lidhje me depolitizimin e politikëbërjes është i qëndrueshëm kur ky konsensus nuk prodhon as konvergjencë ekonomike dhe politike dhe as përparim të dukshëm në rrugën zyrtare drejt BE-së. Politika kombëtare e integritimit evropian në rajon ka shumë të ngjarë të përfundojë me zhgënjim, sepse ajo mund t'i shpëtojë fare lehtë kontrollit dhe vëmendjes së publikut dhe ta bëjë Brukselin cjap për kurban. Por BE është ende në kohë dhe në gjendje të parandalojë zhgënjimin popullor me integritimin

dhe demokracinë duke forcuar besueshmërinë e perspektivës evropiane të rajonit dhe duke mbajtur një qëndrim pa kompromis kundër korrupsionit ndaj qeverive të Ballkanit Perëndimor.

Njëri zjarr

Procesi i anëtarësimit në BE është i ndërtuar në mënyrë të atillë që politikëbërja përkatëse në vendet e Ballkanit anashkalon diskutimet për politikën. Në fakt, kjo politikëbërje përkthehet në miratim dhe zbatim të standardeve të përputhshme me BE-në. Ndonëse Brukseli e kufizon aftësinë e partive politike në vendet anëtare për të ofruar alternativa të mirëfillta politikash për qytetarët e tyre, të paktën kryeqytetet e BE-së kanë mundësi të thonë fjalën e tyre për vendimet që merren në nivel evropian, vendime që më vonë janë të detyruar t'i respektojnë. Si shtete që synojnë anëtarësimin në BE, vendet e Ballkanit Perëndimor janë të detyruara t'i pranojnë ose t'i refuzojnë kushtet e BE-së. Ky dominim i procesit të integritimit në BE në rajon ua bën të vështirë politikanëve të këtyre vendeve të përfaqësojnë dhe t'u përgjigjen nevojave të votuesve të tyre, edhe nëse këta politikanë duan vërtet ta bëjnë një gjë të tillë. Dhe për më tepër, ky dominim ka pasojën e padëshiruar që shpesh u bën të mundur elitave politike në rajon t'i bëjnë bisht premtimeve që kanë bërë në fushatë, "duke i shitur të gjitha politikën jopopullore si 'të prodhuara në Bruksel', ndërkohë që fusin kontrabandë në programet e tyre projektet e tyre të vogla".³ Në pamundësi për t'u kërkuar llogari drejtuesve të tyre, ekziston rreziku që njerëzit në rajon të fillojnë të humbasin besimin tek institucionet dhe te proceset përfaqësuese demokratike.

Deri më sot, qytetarët nga vendet e rajonit që duan të anëtarësohen në BE nuk e kanë refuzuar presionin dhe ndikimin e Komisionit të politikës kombëtare. Sipas një sondazhi të fundit të realizuar nga Ipsos dhe të mbështetur nga Fondi Evropian për Ballkanin në tetor 2020, opinioni publik në rajon vazhdon të tregojë mbështetje tejet të madhe për anëtarësimin në Bashkimin Evropian (me një mesatare prej 82.5%). Madje edhe në Serbi – skeptiku më i madh në rajon – një shumicë prej 64.1% e të anketuarve mbështet synimin e vendit të tyre për anëtarësim në BE (Shih Figurën 1).

1 Ne falënderojmë Donika Emina Nataša Vunč për komentet e tyre.

2 Mair, Peter (2013), "Ruling the void. The hollowing of Western democracy" (Sundimi i zbrazëtisë. Zbehja e demokracisë perëndimore), London: Verso.

3 Krastev, Ivan (2008), "Europe's other legitimacy crisis", Open Democracy.






Figura 1. A jeni dakord që vendi juaj të anëtarësohet në BE?

Nëse njerëzit në Ballkanin Perëndimor e mbështesin ende procesin e integrimit në BE, mund të argumentohet se kjo vjen për shkak se ata e shohin integrimin si mundësi për ndryshimin aq të nevojshëm të cilësisë së qeverisjes dhe performancës ekonomike të vendeve të tyre. Në fakt, sondazhi i Ipsos (2020) evidenton se në të gjithë rajonin qytetarët vlerësojnë pozitivisht rolin e BE-së në reformat politike kombëtare (39.7%) dhe ekonomike (40.3%) (shih Figurën 2). Kjo është pothuajse dyfishi i atyre që vlerësojnë negativisht mbështetjen përkatëse që jepet nga Brukseli (përkatësisht 22.8% dhe 21.4%). Për më tepër, ka të ngjarë që njerëzit në vendet e Ballkanit të pranojnë “kërbaçin” e integrimit evropian, sepse vlerësojnë aspektin tjetër – “kulaçin” e BE-së– që përfshin lirinë për të punuar dhe udhëtuar kudo në BE, por edhe paqen dhe sigurinë.

Si po e shfrytëzon Bashkimi Evropian besimin që qytetarët në Ballkanin Perëndimor duket se i japin atij? Përgjigja e shkurtër nuk është shumë e mirë. Ndikimi i BE-së në rajon mbështetet në tërheqjen e saj; tërheqja e saj qëndron, në një masë të madhe, në besueshmërinë e saj në marrëdhëniet me vendet e rajonit. Por ky ndikim është zbehur gjatë dekadës së fundit, që kur kryeqytetet e BE-së filluan ta bëjnë zakon shpërfilljen e mendimit të Komisionit Evropian dhe të ndërhyrjes së tij në pikat kryesore të vendimmarrjes për zgjerimin me qëllim bllokimin e procesit apo nxjerrjen e tij jashtë binarëve. Këto ndërhyrje shpesh kanë qenë për arsye që lidhen më shumë me politikën e brendshme sesa me vetë procesin që është përcaktuar më parë ose me gjendjen e reformave në vendet e Ballkanit.⁴




Figura 2. Si e vlerësonin rolin e BE-së në reformat politike dhe në procesin e demokratizimit të vendit tuaj?

4 Balfour, Rosa dhe Stratulat, Corina (red.) (2015), “EU member states and enlargement towards the Western Balkans” (Shtetet anëtare të BE-së dhe zgjerimi drejt Ballkanit Perëndimor), EPC Issue Paper, Bruksel: Qendra Evropiane Politike.

Kohët e fundit, Bullgaria refuzoi miratimin e kornizës së negociatave të anëtarësimit në BE për Maqedoninë e Veriut për shkak të problemeve me këtë vend për sa i përket historisë dhe gjuhës, duke penguar kështu efektivisht edhe fillimin tashmë të vonuar të bisedimeve të anëtarësimit për Shkupin. Ky vendim nuk mori parasysh progresin e konsoliduar të reformave të ndërmarra në Maqedoninë e Veriut, e cila mori vlerësimin më pozitiv në raportet e Komisionit të këtij viti për vendet e Ballkanit. Përplasja me Greqinë për emrin e kishte zhgënjyer për më shumë se një dekadë Maqedoninë e Veriut në përpjekjet e saj për t'u anëtarësuar në BE, deri kur të dy vendet zgjidhën përfundimisht çështjen e emrit në vitin 2019.

Nga ana tjetër, procesi ka vuajtur pengesa si në rastin e Kosovës. Pavarësisht rekomandimit të Komisionit dhe miratimit nga Parlamenti Evropian në vitin 2018 për liberalizimin e vizave me Kosovën, ecuria e këtij procesi ka ngecur në Këshill. Frika nga emigracioni masiv i mundshëm nga Kosova drejt BE-së ka bërë që vendet anëtare si Franca dhe Holanda ta kundërshtojnë me forcë marrjen e një vendimi për këtë temë, edhe pse Kosova ka përmbushur të gjitha kërkesat teknike për t'u përfshirë në regjimin pa viza me Bashkimin Evropian. Për më tepër, pozicioni i pesë vendeve⁵ të BE-së që nuk e njohin pavarësinë e Kosovës bazohet në frikën e

ndikimit të shtetësisë së Kosovës tek raste të ngjashme që përbëjnë shqetësim kombëtar për këto vende.

Shembuj të tillë nuk janë më përjashtim, por po kthehen gjithnjë e më shumë në normë se si kryeqytetet e BE-së i qasen zgjerimit drejt rajonit. Imponimi i shteteve anëtare të kjo dosje mund të dëmtojë procesin, i cili aktualisht është mjaft i ngadaltë dhe po lufton për të korrur suksese.

Opinionet publik në rajon ka ende qëndrim pozitiv ndaj integritetit evropian, por nuk është i përfunduar për këto dinamika që po shpalosen. Sondazhi i Ipsos (2020) tregon se 52.1% e të anketuarve nga i gjithë rajoni janë të pakënaqur me përparimin e vendit të tyre drejt anëtarësimit në BE. Siç tregohet në Figurën 3, një nga arsyet e cituara për këtë pakënaqësi ka të bëjë pikërisht me ritmin e ngadaltë të procesit, veçanërisht me vendet kryesore kandidate si Mali i Zi (17.7%) dhe Serbia (17.6%). Për Serbinë, ky është burimi që raportohet më shumë për sa i përket pakënaqësisë së evidentuar në sondazh. Po ashtu, 9.4% e të anketuarve në Maqedoninë e Veriut dhe 11.7% në Serbi ankohen edhe për rritjen e numrit të kërkesave të BE-së për vendin e tyre dhe shprehin shqetësimin se "BE nuk na do". Kushtet e vendosura nga vendet fqinje janë zhgënjyese për 9% të të anketuarve në Maqedoninë e Veriut.




Tabela 3: Cila është arsyeja për pakënaqësinë tuaj me progresin në lidhje me anëtarësimin në BE?

5 Kipar, Grčka, Rumunija, Španija i Slovačka.



Edhe pse të vogla, këto shifra tregojnë se opinioni publik në Ballkanin Perëndimor është i vëmendshëm dhe i ndjeshëm ndaj sinjaleve nga BE. Në fakt, skepticizmi i fshehtë i njerëzve bëhet edhe më i dukshëm kur merren parasysh përqindjet e konsiderueshme të popullsisë në rajon (mesatarisht 20,8%) në sondazhin e Ipsos (2020) që besojnë se vendet e tyre nuk do të anëtarësohen kurrë në BE: 32.7% në Serbi, 28.1% në Bosnjë dhe Hercegovinë, 25.7% në Maqedoninë e Veriut dhe 20.9% në Shqipëri. Këto rezultate janë edhe më të mëdha nëse përfshihet përqindja e atyre që mendojnë se vendit të tyre do t'i duhen më shumë se 20 vjet për të hyrë në Bashkimin Evropian. Kjo e rrit përqindjen deri në më shumë se 44.9% të të anketuarve në Bosnjë dhe Hercegovinë, 42% në Serbi, 40.5% në Maqedoninë e Veriut dhe 36.8% në Shqipëri që presin që vendi i tyre të bëhet anëtar i BE-së vetëm pas vitit 2040 apo edhe asnjëherë.

Zjarri tjetër

Për momentin, sipas sondazhit të Ipsos (2020), fokusi i pakënaqësisë së qytetarëve janë politikanët e tyre dhe institucionet në vend (shih Figurën 4). Në mënyrë të veçantë, më shumë të anketuar nga Kosova (24%) se kudo tjetër në rajon dyshojnë se autoritetet janë të angazhuar seriozisht për integrimin evropian; këta njerëz nuk besojnë më në mbështetjen e përbetuar të udhëheqësve të tyre për agjendën e BE-së. Kjo është edhe arsyeja e nivelit më të lartë të zhgënjimit që kanë njerëzit në Ballkanin Perëndimor në përgjithësi. Edhe pakënaqësia e publikut me institucionet shtetërore të korruptuara dhe jofunksionale ka përqindje të konsiderueshme, veçanërisht në Malin e Zi (18%). Rreth 14% e të anketuarve në Serbi dhe në Maqedoninë e Veriut janë dakord se elitat politike dhe institucionet në vend janë kryesisht përgjegjëse për mungesën e progresit apo të reformave për integrimin evropian.




Figura 4. Mendoni se anëtarësimi në BE do të ndodhë në 5/10/20 vjet apo kurrë?

Rrjedhimisht, asnjë deklaratë e madhe politike për mbështetje të bërë, për shembull, në Samitin e Ballkanit Perëndimor, apo shpërblimet ndërmjetësuese të premtuara ose të ofruara nga BE (si akses i tregut, rritja e ndihmës financiare apo liberalizimi i vizave) nuk ka të ngjarë të mjaftojnë në periudhën afatgjatë për të vazhduar të fitohen zemrat dhe mendjet e njerëzve në rajon. Niveli aktualisht i lartë i mbështetjes popullore për BE-në në rajon do të jetë i qëndrueshëm ndofta për sa kohë që perspektiva e anëtarësimit të vërtetohet se është e besueshme. Pak nga pak kohës kur BE mund të marrë si të mirëqenë ndjenjën pro-evropiane në vendet e Ballkanit po i vjen fundi.

Perceptimet e njerëzve nuk janë të gabuara. Pas gati dy dekadash integrimi evropian, performanca demokratike në të gjithë rajonin nuk ka marrë ende një dinamikë pozitive. As miratimi i kushtetutave demokratike dhe as kushtëzimi rigoroz demokratik i BE-së nuk ia kanë dalë të ngadhënjëjnë mbi strukturat informale të pushtetit, kapjen e shtetit dhe patronazhin; përkundrazi, i kanë konsoliduar këto të fundit.⁶ Ngritja e sunduesve të fortë në Ballkan ka gërryer shtetin ligjor, pavarësinë e gjyqësorit dhe lirinë e medias në këto vende, duke u bërë të mundur udhëheqësve me mendësi autokratike të qeverisin pa asnjë kontroll. Pavarësisht raporteve për rritjen në nivele shqetësuese të sundimit personal në Ballkanin Perëndimor⁷, Komisioni në mënyrë efektive

6 Richter, Solveig dhe Wunsch, Natasha (2020), "Money, power, glory: the linkages between EU conditionality and state capture in the Western Balkans" (Paratë, pushteti, lavdia: lidhjet mes kushtëzimit të BE-së dhe kapjet së shtetit në Ballkanin Perëndimor), *Journal of European Public Policy* 27(1), 41-62.

7 Për shembull në Komunikimin e Komisionit në 2018 për zgjerimin, "A credible enlargement perspective for and enhanced EU engagement with the Western Balkans" (Perspektiva e mundshme e zgjerimit dhe rritja e angazhimit të BE-së me Ballkanin Perëndimor), COM(2018) 65 final, p. 3.

ka bërë një sy qorr ndaj politikanëve që sfidojnë ligjin në rajon sa herë që kanë përmbyllur me sukses çështje me përparësi të lartë për vendet anëtare të BE-së, si mbyllja e kufijve për refugjatët, radikalizimi dhe terrorizmi, apo stabiliteti në rajon. Praktika në rritje në Këshill për mosdhënien e shpërblimeve të premtuara, pavarësisht përparimit të prekshëm, i demotivon më tej politikanët e Ballkanit në zbatimin e programit të reformave të BE-së.

Duke i qëndruar 'lepe-peqe' qëllimit të integritetit evropian ndërkohë që kujdesen vetëm për interesin e tyre dhe të disa ndërmarrjeve të huaja të zgjedhura⁸, qeveritë e Ballkanit Perëndimor bënë pak për të parandaluar rrëshqitjen e vendeve të tyre nga një regres ekonomik në tjetrin. Që nga kriza financiare dhe ekonomike e vitit 2008, procesi i konvergjencës ekonomike me BE-në për sa i përket PBB-së për frymë ka qenë shumë i ngadaltë ose inekzistent. Në pamundësi për të përshpejtuar zhvillimin ekonomik nëpërmjet ndreqjes së problemeve strukturore, si mungesa e investimeve publike dhe private ose plakja e shpejtë e popullsisë, qytetarët e Ballkanit Perëndimor kanë kuptuar dhe ndjehen të pafuqishëm ndaj të ardhmes ku i pret një privim i pamëshirshëm. Pandemia e koronavirusit ka të ngjarë t'i përkeqësojë më tej problemet socio-ekonomike të rajonit, duke përshpejtuar divergjencën ekonomike mes BE-së dhe rajonit dhe duke krijuar një enklavë de facto të nënzhvillimit në mes të Evropës.⁹

Vështirësitë ekonomike dhe mungesa e mundësive në rajon kanë nxitur një vlerësim pozitiv të prosperitetit ekonomik në BE, gjë që evidentohet qartazi në tendencat aktuale të migrimit. Sipas një studimi të fundit,¹⁰ çdo dy minuta një person largohet nga Ballkani Perëndimor si emigrant ekonomik në kërkim të një pune në një vend anëtar të BE-së. Njerëzit në rajon shpesh zgjedhin largimin, sepse nuk ndihen të aftë të ndryshojnë kursin politik në vendin e tyre. Në vend të 'çlirimit' të qytetarëve, procesi teknik i integritetit evropian duket se i ka çliruar pa dashje elitat politike nga kufizimet e llogaridhënies demokratike. Nëse nuk ka asnjë alternativë ndaj "stabilitokracisë"¹¹ kombëtare nën hijen e integritetit evropian në "shtëpi", nuk është habi që njerëzit të kërkojnë alternativa jashtë vendit.

Shpëtimi

Politika e presionit, ku qeveritë e korruptuara e shohin veten të ndrydhur mes publikut të inatosur dhe Këshillit të palëkundur, i ka vërtetuar limitet e saj. Ndërkohë që vendet anëtare vazhdojnë të ndryshojnë në terma funksionale për sa i përket standardeve dhe procedurave të miratuara për zgjerimin, besueshmëria dhe ndikimi i politikës në Ballkanin Perëndimor po zbehet. Frenimet e vazhdueshme në rrugën e këtyre vendeve drejt BE-së rrezikojnë të nxjerrin jashtë shinave edhe politikanët më të predispozuar për reforma dhe më të prirur për konsensus në rajon. Për ta mbajtur procesin në lëvizje, Komisionit i duhet të merret me elitat politike rajonale që kanë kredenciale të dyshimta demokratike. Njerëzit në rajon mund të ndjehen gjithnjë e më të frustruar me performancën e udhëheqësve të tyre, por nuk janë në gjendje t'u kërkojnë llogari në një proces të depolitizuar të integritetit evropian. Në vetvete, kjo i jep një goditje të rëndë legjitimitetit dhe kapacitetit të sistemeve të Ballkanit Perëndimor. Në fund të fundit, nëse është dikush që aktualisht bëhet si 'sanduiç' në këtë proces, ata janë njerëzit e thjeshtë, që gjenden të ndrydhur mes dy angazhimeve të padëshiruara: asaj ndaj BE-së për zgjerimin dhe asaj ndaj elitave të tyre politike për agjendën e reformave.

Nuk ka gjasa që BE të mund të bëjë më shumë për të rregulluar perceptimin në Ballkanin Perëndimor se demokracia në këtë rajon ka shkuar përtej përfshirjes dhe kontrollit të popullit - një pikëpamje e përhapur edhe në vendet anëtare¹². Por BE-ja ende mund të bëjë më shumë për të përmirësuar besueshmërinë e politikës së zgjerimit dhe për të mbështetur luftën e publikut për eliminimin e korrupsionit dhe për t'i kërkuar llogari qeverive.

Në këtë drejtim, zbatimi i metodologjisë së rishikuar të zgjerimit të miratuar nga Komisioni në fillim të këtij viti, në bazë të propozimeve franceze, nuk duhet të vonohet më. Duke qenë se qëllimi i këtij rishikimi ishte ta bënte procesin më të besueshëm, më të parashikueshëm dhe politik, Komisioni duhet ta zbatojë atë menjëherë për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut dhe të sqarojë se si do ta përshtatë atë në rastin e Malit të Zi dhe Serbisë, që tashmë janë duke negociuar me BE-në dhe që kanë shprehur vullnetin për ta miratuar atë.

8 Will Bartlett, Besnik Krasniqi dhe Jasmina Ahmetbašić (2019), "Attracting FDI to the Western Balkans: Special Economic Zones and Smart Specialisation Strategies" (Tërheqja e Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta në Ballkanin Perëndimor: Zonat e Veçanta Ekonomike dhe Strategjitë Inteligjente të Specializimit), në Revistën Ekonomike Kroate 21(2), 5-35, <https://doi.org/10.15179/ces.21.2.1>.

9 Bonomi, Matteo dhe Reljić, Dusan (2017), "The EU and the Western Balkans: so near and yet so far" (BE dhe Ballkani Perëndimor: kaq pranë por edhe kaq larg), Stiftung Wissenschaft und Politik (SWP) Kommentar, SWP.

10 Bonomi, Matteo, Merja, Albana, Töglhofer, Theresia dhe Reljić, Dušan (2020), "Make or break moment: EU enlargement in Southeast Europe in pandemic times" (Bëje ose shkatërroje çastin: Zgjerimi i BE-së drejt Evropës Juglindore në kohë panedmie), Friedrich Ebert Stiftung, p. 5.

11 Kmezić, Marko dhe Bieber, Florian (red.) (2017), "The crisis of democracy in the Western Balkans. An anatomy of Stabilitocracy and the limits of EU democracy promotion" (Kriza e demokracisë në Ballkanin Perëndimor. Anatomia e Stabilitokracisë dhe kufijtë e promovimit të demokracisë së BE-së), Studimet politike të Biepag.

12 Mair (2013), op. cit.



Në një farë mase, zbatimi i qasjes së re për zgjerimin e BE-së varet nga aftësia e vendeve anëtare për të miratuar kornizën negociuese për Maqedoninë e Veriut. Kjo na risjell në mendje nevojën e kahershme për të përcaktuar më mirë ndarjen e punës mes Komisionit dhe kryeqyteteve të BE-së në lidhje me dosjen. Duke pasur parasysh vështirësitë e vendeve anëtare për të arritur unanimitetin për zgjerimin, Këshilli duhet të rishikojë mundësinë e futjes së votimit me shumicë të kualifikuar, të paktën për të gjitha fazat e ndërmjetme të procesit të anëtarësimit në BE¹³. Kjo do t'u jepte vendeve anëtare një rol të fortë politik, sipas vetë qëllimit të metodologjisë së re. Megjithatë, kjo do t'i pengonte ato të dëmtonin procesin gjatë kohës që ai është në vazhdim, që është pikërisht ajo që aktualisht minon forcën transformuese të politikës.

Ideja e qasjes së re – për të nxitur rrugën e mundimshme të reformave të rajonit me stimuj më të shpeshtë për udhëheqësit e Ballkanit me qëllim që të bëjnë përparim të qëndrueshëm - është bërë, po ashtu, gjithnjë e më e rëndësishme, veçanërisht në realitetin pas-COVID-19. Për të ndihmuar vendet e Ballkanit Perëndimor në zbutjen e efekteve të pandemisë dhe për rinisjen e konvergencës ekonomike me BE-në, Bashkimi Evropian duhet të ofrojë mbështetje më bujare për rajonin - përtej Planit Ekonomik dhe të Investimeve të shpallur nga Komisioni këtë tetor. BE duhet t'i fuqizojë vendet e Ballkanit përmes politikave inteligjente, gjithëpërfshirëse dhe ndoshta të kushtueshme.¹⁴ Për shembull, hapja graduale e Fondeve Strukturore Evropiane dhe të Investimeve (si mbështetja e projekteve infrastrukturore), shtrirja e përdorimit të mekanizmave të stabilitetit financiar të BE-së, duke lejuar rajonin të marrë pjesë në Politikën e Përbashkët Bujqësore ose mundësimi i migrimit qarkullues, të gjitha këto kërkojnë një shqyrtim serioz.

Metodologjia

Të dhënat parësore që përdoren në këtë analizë politikash të BiEPAG vijnë nga një sondazh i opinionit publik të kryer në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor në muajin tetor 2020. Sondazhi u krye me një kampion përfaqësues kombëtar prej 1,000 të anketuarish të moshës mbi 18 vjeç, nëpërmjet intervistave telefonike dhe online duke ndjekur këtë raport: Shqipëria (telefon + online, 90:10), Bosnje-Hercegovina (telefon + online, 80:20), Kosova (telefon, 100), Mali i Zi (telefon + online, 90:10), Maqedonia e Veriut (telefon + online, 90:10) dhe Serbia (telefon + online, 80:20). Rezultatet jepen në përqindje dhe janë subjekt i gabimeve të mëposhtme statistikore: Shqipëria ±3.39%, Bosnje-Hercegovina ±3.39 %, Kosova ±3.32%, Mali i Zi ±3.36%, Maqedonia e Veriut ±3.34 % dhe Serbia ±3.38%. Mbledhja e të dhënave u realizua nga Ipsos Strategic Marketing.

Fondi Evropian për Ballkanin 2020. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autor(ëve) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet dhe pikëpamjet e Fondit Evropian për Ballkanin.

- 13 Cvijic, Srdjan, Kirchner, Marie Jelenka, Kirova, Iskra and Nechev, Zoran (2019), "From enlargement to the unification of Europe: Why the European Union needs a Directorate General Europe for future Members and Association Countries" (Nga zgjerimi drejt unifikimit të Evropës: Pse Bashkimi Evropian ka nevojë për një Drejtori të Përgjithshme të Evropës për vendet anëtare dhe të asociimit në të ardhmen), Fondacioni Shoqëria e Hapur.
- 14 Lazarević, Milena dhe Stratulat, Corina (2020), "Letter to Macron: details matter for enlargement reform" (Letër për Makronin: detajet kanë rëndësi për reformën e zgjerimit), Komentari i QPE, Bruksel: Qendra e Politikave Evropiane.
- 15 Lazarević, Milena dhe Stratulat, Corina (2020), "The Conference on the Future of Europe: is the EU still serious about the Western Balkans?" (Konferenca për të ardhmen e Evropës: a po e merr BE ende seriozisht Ballkanin Perëndimor?), Dokument për diskutime i QPE, Bruksel: Qendra e Politikave Evropiane.

Nëbotënesotmetëndërlikuadhetëpaparashikueshme, është domosdoshmëri që BE të forcojë dhe diversifikojë format me të cilat lidhet me aleatët e saj natyrorë në rajon, të cilët, në çdo rast, ndajnë të njëjtat probleme dhe interesa. Një formë konkrete që BE të bëjë një gjë të tillë është të ftojë udhëheqësit politikë dhe qytetarët nga vendet e Ballkanit Perëndimor të bëhen pjesë, sipas konsultimeve, e aktiviteteve dhe diskutimeve që organizohen në kuadër të Konferencës së ardhshme për të Ardhmen e Evropës. Bashkëpunimi përtej kuadrit të dosjes së zgjerimit për të formësuar bashkërisht një të ardhme të përbashkët evropiane mund të ndihmojë edhe në rikthimin në gjendjen fillestare të nivelit të konsiderueshëm të skepticizmit të rajonit ndaj premtimit të anëtarësimit në BE.¹⁵

E fundit por jo për nga rëndësia, BE duhet të jetë në aleancë me njerëzit në këtë rajon kundër qeverive të Ballkanit që nuk dëshirojnë të luftojnë korrupsionin në çdo aspekt të vendit. Dështimi i BE-së për t'u përbashkëtuar me ngërçet e vazhdueshme ose hapat prapa në reformat demokratike në rajon lë përshtypjen se ajo është e gatshme të bëjë lëshime në dëm të demokracisë dhe në këmbim të premtimit për stabilitet në Ballkanin Perëndimor. Në mungesë të një acquis demokratik, BE është ende në kërkim të një strategjie të duhur për të transformuar vendet e rajonit në demokraci të qëndrueshme. Po ashtu, BE ka nevojë për tregues objektivisht të verifikueshëm për matjen e progresit të tyre. Ndërkohë, gjithsesi, BE nuk duhet t'u bëjë lëshime udhëheqësve në rajon që shmangin qartë angazhimin e tyre ndaj demokracisë. Shkalla e denoncimit të 'kapjes së shtetit' në strategjinë e vitit 2018 të Komisionit për rajonin, ose vlerësimi kritik i vendeve të ndryshme në raportet vjetore, ulet ndjeshëm nëse e njëjta retorikë nuk ritheksohet nga zyrtarët e BE-së ose nga politikanët e vendeve anëtare që udhëtojnë në rajon. Duke bërë të gjitha sa më sipër, BE do ta bënte politikën kombëtare në Ballkan më pak të vështirë dhe do të zgjidhte sfidën e qasjes së saj aktuale ndaj rajonit.



<https://biepag.eu>

Grupi Këshillimor i Politikave 'Ballkani në Evropë' (Balkans in Europe Policy Advisory Group -BiEPAG) është një nismë e përbashkët e Fondit Evropian për Ballkanin (European Fund for the EFB) dhe Qendrës për Studimet e Evropës Juglindore të Universitetit Graz (CSEES) që promovon integrimin evropian të Ballkanit Perëndimor dhe konsolidimin e vendeve demokratike e të hapura në rajon. BiEPAG bazohet te vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Ai respekton vlerat që janë të përbashkëta për një shoqëri ku mbizotëron pluralizmi, mosdiskriminimi, toleranca, drejtësia, solidariteti dhe barazia mes grave dhe burrave.

Ky grup përbëhet nga hulumtues të njohur politikash nga rajoni dhe vende të tjera të Evropës që kanë njohuri të thella për Ballkanin Perëndimor dhe për proceset që formësojnë këtë rajon. Aktualisht, anëtarët e këtij grupi janë: Florian Bieber, Matteo Bonomi, Dimitar Bechev, Srđan Cvijić, Marika Djolai, Milica Delević, Vedran Džihic, Donika Emini, Dejan Jović, Marko Kmezić, Jovana Marović, Srđan Majstorović, Milan Nič, Zoran Nechev, Tena Prelec, Corina Stratulat, Nicolaos Tzifakis, Alida Vračić, Gjergi Vurmo, Jelena Vasiljević, dhe Natasha Wunsch.

www.balkanfund.org

Fondi Evropian për Ballkanin është një nismë e përbashkët e Fondacionit Erste, Fondacionit Robert Bosch dhe Fondacionit King Baudouin që parashikon dhe lehtëson nisma që forcojnë demokracinë, nxisin integrimin evropian dhe afirmojnë rolin e Ballkanit Perëndimor në trajtimin e sfidave të Evropës. Strategjia e saj është e përqendruar në tre fusha kryesore - promovimi i demokratizimit, përmirësimi i bashkëpunimit rajonal dhe nxitja e integritetit në BE.

EFB mbështet procesin e afirmimit të efikasitetit të politikës së zgjerimit të BE-së në të gjithë Ballkanin Perëndimor, duke përmirësuar bashkëpunimin rajonal mes organizatave të shoqërisë civile bazuar në solidaritet dhe dialog sipas kërkesës. Ai ofron mjetet dhe platformën ku qytetarë të informuar dhe të fuqizuar të ndërmarrin veprime në kërkim të institucioneve të përgjegjshme dhe demokracisë. Fokusi është te reformat e vazhdueshme të politikave dhe praktikave të vendeve të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE.

Kontakt: ALEKSANDRA TOMANIĆ, Drejtore Ekzekutive, aleksandra.tomanic@balkanfund.org

www.suedosteuropa.uni-graz.at

Qendra për Studime të Evropës Juglindore u krijua në nëntor 2008 pas vendosjes së Evropës Juglindore si përparësi strategjike në Universitetin e Grazit në vitin 2000. Qendra është një institucion ndërdisiplinar me pjesëmarrje të disa fakulteteve për kërkimin dhe edukimin, që ka si qëllim të sigurojë hapësirë për aktivitetet e pasura mësimore dhe kërkimore në universitet për Evropën Juglindore dhe të promovojë bashkëpunimin ndërdisiplinar.

Po ashtu, Qendra synon të ofrojë informacione dhe dokumentim dhe të jetë pikë kontakti për mediat dhe publikun e interesuar në Evropën Juglindore përsa i përket zhvillimeve politike, ligjore, ekonomike dhe kulturore. Në kërkimet për Evropën Juglindore ka kontribuar një ekip ndërdisiplinar juristësh, historianësh dhe shkencëtarësh politikë, përmes artikujve, monografive dhe botimeve të tjera. Qendra organizon konferenca dhe seminare ndërkombëtare rregullisht për të promovuar hulumtime të mirëfillta shkencore për Evropën Juglindore.

Kontakt: Profesor Universiteti DR. FLORIAN BIEBER, Profesor i Studimeve të Evropës Juglindore, florian.bieber@uni-graz.at

Kontakt: UNIV.PROF. DR. FLORIJAAN BIBER, profesor studija Jugoistočne Evrope, florian.bieber@uni-graz.at